



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

KARTELË SHIQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Min. Financave Nr. 11803/1 Prot., datë 31.8.17  
Marrësi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Nr. 19994/1 Prot., hyrës datë 9.9.17  
Shkurtimi i lëndës Kthim perop.

Per trajtim nga:	<u>Dep. te Shkencave</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	<u>Nu merret meqytetere qesat publike per shkrimin e shkrimit</u>

AFAT:  Normal (7 ditë) |  Prioritet (3 ditë) |  Urgjent (brenda ditës) |  Pa afat/për dajeni

Tjetër \_\_\_\_\_ ditë

Data \_\_\_\_\_, Nr. Prot \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi: (TITULLARI) [Signature]

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_,

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim Specialistit: \_\_\_\_\_,

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar më: \_\_\_\_\_, Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike



Shyzo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE  
DHE ÇËSHTJEVE FISKALE  
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ANALIZAVE FISKALE

Nr. 11803/1 Prot.

Tiranë, më 31/08/2017

Lënda: Kthim përgjigje

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Laprakë, Tiranë

NT 19394/1  
Data 09.09.17

Znj. Ikonimi,

Në vijim të shkresës suaj nr. 19394 Prot., datë 25.08.2017, me lëndë "Informacion, lidhur me situatën për mbledhjen e detyrimeve të akcizës për produktin solar, që përdoret si hollues i naftës bruto në procesin teknologjik të nxjerrjes nga nëntoka", ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në zbatim të Ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke filluar nga data 1 Prill 2014, nuk ka përjashtim për produktin solar, që përdoret si hollues në proceset e nxjerrjes së naftës bruto. Bazuar në nenin 14 të ligjit të akcizave, akciza nuk rimbursohet për nënproduktet e naftës të përdorura për nevojat e veta nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, pavarësisht nga destinacioni i përdorimit. Sipas nenit 4, pika 3/c të ligjit, për mallrat e akcizës detyrimi lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor, duke përfshirë edhe momentin e konsumimit të produkteve të akcizës për qëllime vetjake, brenda ambienteve të magazinës fiskale.

Vendimet gjyqësore të gjykatave administrative të cilët i referohen një çështjeje konkrete në një moment të caktuar, nuk mund në asnjë rast të çënojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër, të merren të gjitha masat në zbatim të ligjit për vjeljen e detyrimeve të akcizës prej hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të përmendura.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Helga Vukaj

Në Mungesë dhe me Urdhër

Erjon Luçi



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al), e-mail: [info@financa.gov.al](mailto:info@financa.gov.al)



MINISTRIA E FINANCAVE  
 Nr. 14589/1 Prot  
 Datë 25.5.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E FINANCAVE  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 19394 Prot.

Tiranë më 25.5.2017

**Drejtuar:** Z. Nikolla Lera  
 Drejtor i Përgjithshëm  
 Drejtoria e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale  
 Ministria e Financave

Znj. Gelardina Prodan  
 Sekretar i Përgjithshëm  
 Ministria e Financave

**Per dijeni:** Z. Erjon Luci  
 ZV/Ministër  
 Ministria e Financave

**Lënda:** Informacion, lidhur me situatën për mbledhjen e detyrimeve të akcizës për produktin solar, që përdoret si hollues i naftës bruto në procesin teknologjik të nxjerrjes nga nëntoka.

Te nderuar,

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në mbështetje të legjislacionit përkatës si dhe shkresës së Ministrisë së Financave Nr. 14589/1 prot MF dt. 11.11.2016 përgjatë vitit 2017 ka fokusuar punën e saj në drejtim të mbledhjes së detyrimeve të akcizës për produktin solar që përdoret si hollues i naftës bruto në procesin teknologjik të nxjerrjes nga nëntoka.

Aktualisht dy janë subjekte naftënxjerrëse të cilët përdorin holluesin për nevojat e tyre gjatë procesit teknologjik. Për këtë arsye, Departamenti i Akcizës në mbështetje të legjislacionit hartoi dhe ndër morri disa kontrole pranë operatorëve ekonomikë, konkretisht pranë operatorit:

- TRANS OIL GROUP SHIA me nipt L11725004I, magazinë fiskale prodhimi me adresë: Visokë, Ballsh, Fier (Program Kontrolli nr. 1131 prot DPD dt. 16.01.2017).

*Handwritten notes and signatures:*  
 - "Sogusca" (top)  
 - "Alte to" (middle)  
 - "Te konsultohet edhe me Drejtorin e Përgjithshëm" (middle)  
 - "Pergjohur" (middle)  
 - "Tiranë" (multiple locations)  
 - "28/8/17" (middle)  
 - "detyrues" (right side)  
 - "për" (right side)  
 - "2017" (right side)  
 - "U. [Signature]" (bottom right)

- BANKERS PETROLEUM ALBANIA SHIA” BPAI me nipt K43128401L, magazinë fiskale prodhimi me adresë: Patos-Marinëz, Fier (Program Kontrolli nr.29034 prot DPD dt.13.12.2016)

1. Lidhur me Program Kontrolli nr.1131 prot DPD dt.16.01.2017 te ushtruar pranë TRANS OIL GROUP SHA me nipt L117250041, magazinë fiskale prodhimi me adresë: Visokë, Ballsh, Fier Grupi i Kontrollit konstatoi një sasi prej 2.177.820 kg solar (hollues) të hedhur për konsum, përdorur për hollues gjatë procesit teknologjik të nxjerrjes së naftës nga nëntoka sipas deklaramit të operatorit fiskal, pa paguar detyrimet e akcizës 80.579.340 lekë.

Për këtë sasi të hedhur në konsum pa paguar detyrimet, grupi i kontrollit e klasifikoi si shkelje administrative dhe përveç pagesës së detyrimit të munguar (80.579.340 leke), bazuar në nenin 90 pika 1 të Ligjit 61/2012 vendosi gjobë në shumën 241.738.020 lekë sa tre-fishi i detyrimit të munguar. Bazuar në konstatimet e grupit të kontrollit, D.D.Fier ka marrë Vendimin Administrativ Nr.22 datë 11.04.2017.

2. Lidhur me Shoqerine “Bankers Petroleum AL”, DPD ka filluar kontrollin sipas Programit të Kontrollit Nr.29034 Prot DPD dt.13.12.2016, por ka pezulluar veprimet e mëtejshme konkluduese për këtë kontroll, pasi Administrata Doganore ne lidhje me ceshtjen e pageses se akcizes per holluesin qe perdor kjo shoqeri ndodhej perpara vendimit gjyqesor për “Marrjen e Masës së Sigurimit të Padisë” i vitit 2014. Ky vendim gjyqësor pezullonte veprimet administrative deri ne shqyrtimin me vendim gjyqesor te formes se prere te padise se ngritur nga Shoqeria “Bankers Petroleum AL” kunder Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

Ecuria e ketij procesi gjyqesor praqitet si me poshte:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr.7810, date 29.12.2014, ka vendosur:

1. *Pranimin e Padise se Paditesit Bankers Petroleum Albania LTD.*
2. *Shfuqizimin teresisht te akteve administrative te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (i) Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014; dhe (ii) Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 “Per akcizat ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar;*
3. *Saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit Bankers Petroleum Albania LTD dhe te paditurit Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne lidhje me detyrimin e pretenduar nga i padituri per pagesen e akcizes sipas akteve administrative Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014;*
4. *Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr. 2375472 Prot., date 13.10.2014 (Revokimi i Autorizimit te Magazines Fiskale ne Prodhim) ne*

zbatim të Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rregullimin e pasojave juridike që vijnë nga ky shfuqizim duke rikthyer palet në situatën e mëparshme, duke i rikthyer/leshuar Paditesit Autorizimin e Magazines Fiskale në Prodhim;

- Ligjërimin e masës së sigurimit të marë në datën 15.10.2014 me anë të së cilës është vendosur Sigurimin e Padise duke pezulluar zbatimin e akteve administrative Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si edhe të pezullimit të detyrimit të akcizes deri në saktësimin e të drejtave të Paditesit, si edhe të cdo akti administrativ nxjerrë në zbatim të këtyre dy akteve administrative nga vete i Padituri apo organet e vartësisë (si i tillë i pezulluar edhe Akti Administrativ nr. 23754/2 i Revokimit të Autorizimit të Magazines Fiskale të datës 10 tetor 2014) dhe mosmarrjen nga ana e të Paditurit të asnjë veprimi, ose nxjerrje akti, urdhri apo vendimi për caktimin e detyrimeve në lidhje me akcizen dhe pezullimin e pasojave juridike që burojnë nga këto veprime administrative, deri në përfundim të shqyrtimit të padisë në lidhje me saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve mes paleve në gjykim deri në përfundim të procesit gjyqësor .
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës të paditur.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë përmes vendimit Nr. 2501, datë 01.06.2017, vendosi:

« Prishjen pjesërisht të vendimit Nr.7810, date 29.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes në lidhje me kërkimin e padisë për shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 20805, datë 05.09.2014.

Lënien në fuqi të vendimit nr. 7810, datë 20.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. »

Lutem gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese Vendimet Gjyqësore të sipercituara.

Pra DPD nga viti 2014 deri në 1 Qeshor 2017, nuk ka proceduar me vjeljen e taksës së akcizes për holluesin që përdor Shoqëria "Bankers Petroleum Albania" për shkak të vendimit gjyqësor për marrjen e masës së sigurimit të padisë cituar më lart.

Duke iu referuar ngushtësisht dispozitivit të vendimeve gjyqësore, rezulton se:

- Gjykata ka shfuqizuar vetëm dy akte administrative të nxjerrë nga Autoriteti Doganor;
- Gjykata nuk ka listuar apo saktësuar shprehimisht të drejtat dhe detyrimet ndërmjet Bankers dhe DPD (kërkim ky i shoqërisë Bankers).

Ndërsa po ti referohemi pjesës arsyetuese të vendimeve gjyqësore, gjykata në kuadër të akteve administrative që ishin objekt kundërshtimi në padi, është shprehur /ka argumentuar të drejtën e shoqërisë "Bankers Petroleum Albania" për të mospaguar akcizen për holluesin e përdorur në proceset e saj teknologjike.

shoqërise Bankers Petroleum Albania dhe nuk ka kufizuar te drejtat e Autoritetit Doganor, Autoriteti Doganor mund te procedojë ne zbatim te legjislacionit ne fuqi te akcizave per vjeljen e shumes se akcizes për holluesin, por nga ana tjetër, risku qe mbart ky veprim nga Autoriteti Doganor, eshte perplasja me pjesen arsyetuese te vendimit gjyqësor.

Ne përfundim, te ndodhur perpara nje situate te tille, ku edhe shuma qe duhet arketuar nga shoqëria "Bankers Petroleum Albania" ze nje peshe e rëndesishme ne buxhetin e vitit 2017, lutemi qëndrimin Tuaj dhe na udhëzoni për procedurën e mëtejshme që duhet të ndërmerrem.

Duke Ju falenderuar, mbetemi ne pritje te prononcimit Tuaj si organ epror.

**DREJTORTI PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE MAKROEKONOMIKE DHE ÇESHTJEVE  
FISKALE  
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE POLITIKAVE FISKALE

14589/  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot /

Tiranë, më 11/11/2016

Drejtuar: ZNJ. BELINDA IKONOMI  
Drejtore të Përgjithshme të Doganave  
Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", Laprakë, Tiranë

Subjekti: Mbi akcizën për holluesin e naftës bruto

E nderuar znj. Ikonomi,

Në vijim të shkresës suaj nr. 24526 datë 2.10.2016, protokolluar në Ministrinë e Financave me nr. 14589 datë 24.10.2016, " Informacion në lidhje me operatorin Bankers Petroleum Albania" sjellim në vëmendje sa vijon :

Sa ka ndodhur në të kaluarën, lidhur me moszbatimin e ligjshmërisë nga kompania Bankers Petroleum, do të mbahet në ndjekje për të konkluduar zgjidhjen optimale, por kjo nuk duhet të ndikojë në detyrimin për zbatimin e ligjit.

Në zbatim të ligjit të akcizës, prej datës 1 Prill 2014, nuk ka përjashtim për karburantin që përdoret si hollues në proceset e nxjerrjes së naftës. Bazuar në nenin 14 të ligjit të akcizave, akciza nuk rimbursohet për nënproduktet e naftës të përdorura për nevojat e veta nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, pavarësisht nga destinacioni i përdorimit. Sipas nenit 4, pika 3/c të ligjit, për mallrat e akcizës detyrimi lind në momentin e hedhjes së mallit për konsum në territor, duke përfshirë edhe momentin e konsumimit të produkteve të akcizës për qëllime vetjake, brenda ambienteve të magazinës fiskale.

Në buxhetin për vitin 2017, është parashikuar shtesë në planin e akcizës vetëm për holluesin e naftës bruto në vlerë 1.3 miliardë lekë. Sa më sipër, të merren të gjitha masat me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit lidhur me akcizën për holluesin e naftës.

Me respekt,

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR